

REPUBLICA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO	
MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS MINISTARSTVO INFRASTRUKTURE MINISTRY OF INFRASTRUCTURE	
Njësia Org. Org. Jerinica Org. Unit	KM-MIT
Nr i Faqeve Bc. Stranica No. Pages	2
Nr. i Prot. Broj Prot. Prot. No.	218/19
Data : Datum : Date :	19.04.19
PRISHTINE/A	



REPUBLICA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO	
MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS MINISTARSTVO INFRASTRUKTURE MINISTRY OF INFRASTRUCTURE	
Njësia Org. Org. Jerinica Org. Unit	01
Nr i Faqeve Bc. Stranica No. Pages	01
Nr. i Prot. Broj Prot. Prot. No.	4158
Data : Datum : Date :	19.04.19
PRISHTINE/A	

**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
**Qeveria -Vlada-Government**

Ministria e Infrastrukturës dhe Transportit/Ministarstvo Infrastrukture i Transporta  
Ministry of Infrastructure and Transport

Ministri i Ministrisë së Infrastrukturës dhe Transportit , në mbështetje të nenit 145 (paragrafi 2) , të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 17 (paragrafi 5 dhe paragrafi 6) dhe nenin 38 (paragrafi 3) të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive (22.03.2011), Rregulloren Nr.26/2018 për ndryshimin dhe plotësimin e rregullores Nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, nenin 131 të Ligjit nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, nenin 5 dhe 21 të Ligjit nr.04/L-179 për Transportin Rrugor, nenin 7 të Udhëzimit Administrativ 09/2013 për rrjetin e linjave dhe rendin e udhëtimit të transportit ndërrurban të udhëtarëve me autobus, nenin 7 të Udhëzimit Administrativ nr. 06/2016 dhe rekomandimit të komisionit profesional, nxjerr këtë:

### VENDIM

**I. Aprovohet** kërkesa nr.2122 e Operatorit të transportit rrugor të udhëtarëve me autobus N.T.T. "Halimaj Reisen" me seli në Prizren për marrjen e nisjeve në relacionin Prizren-Suharekë- Prishtinë dhe anasjelltas me oraret e nisjeve (08:40 - 11:45; 13:45 - 16:55 ; 18:30 - 07:15).

### Arsyetim

Pas shqyrtimit të aplikacioneve dhe verifikimit të dokumentacionit dhe shkresave të tjera të lëndës dhe duke u bazuar në legjislacionin në fuqi repektivisht Ligjin nr.04/L-179 për Transportin Rrugor dhe Udhëzimin Administrativ nr. 09/2013 mbi rrjetin e linjave dhe rendin e udhëtimit të transportit ndërrurban të udhëtarëve me autobus i plotësuar dhe ndryshuar me Udhëzimin Administrativ nr.06/2016, është konstatuar që operatori transportues rrugor të udhëtarëve me autobus NT.TH. "Halimaj Reisen" me seli në Prizren për marrjen e nisjeve në relacionin Prizren-Suharekë- Prishtinë dhe anasjelltas me oraret e nisjeve (08:40 - 11:45; 13:45 - 16:55 ; 18:30 - 07:15) ka plotësuar kushtet ligjore për ndarjen e nisjeve të lira në relacionin e lartëcekur të përcaktuara sipas nenit 8 të U.A nr. 09/2013 për

rrjetin e linjave dhe rendin e udhëtimit në transportin ner urban të udhëtarëve me autobus si dhe kushtet e shpalljes publike.

Andaj në bazë të kësaj që u tha më lartë, është vendosur si në dispozitiv.

#### Këshilla Juridike:

Kundër këtij Vendimi pala e pa kënaqur mund të parashtrojë ankesë në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Transportit brenda afatit prej shtatë (7) ditësh nga dita e publikimit të vendimit.



I dërgohet:

- Kabinetit të Ministrit;
- Kabinetit të Sekretarit të Përgjithshëm;
- Departamentit të Transportit Tokësor;
- Operatorit Transportues;
- Arhivit.